



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



Raporti i Shqyrtimit Publik të Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës Jugore 2024-2031

Përmbajtja

- 1. Hyrja**
- 2. Vendimi i Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Jugut për hapjen e Shqyrtimit Publik**
- 3. Procesverbali, Lista e pjesmarësve, Fotot e takimit**
- 4. Përmbledhje e rekomandimeve dhe vërejtjeve nga aktiviteti i Shqyrtimit Publik të HZK –së 2024-2031**

1.Hyrja

Harta Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut është hartuar nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, bartëse e të cilit ka qenë Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm. Në këtë proces komuna është mbështetur nga kompania “ INSI”.

Hartimi i Hartës Zonale ka kaluar nëpër një proces të gjithëpërfshirjes, pjesëmarrjes dhe konsultimit të akterëve të ndryshëm dhe palëve me interes të komunës dhe më gjerë gjatë kohës së hartimit të dokumentit. Mënyrat e përfshirjes kanë qenë të ndryshme përfshirë format e punëtorive me pjesëmarrjen më të gjerë si dhe atyre më të fokusuara, konsultime, prezantime publike, takime, aktivitete dhe manifestime të ndryshme e deri te Shqyrtimi Publik si forma e fundit e pjesëmarrjes së publikut prej datës 06.03.2024 deri me datën 07.04.2024 kur edhe është mbyllë.

Është për të ardhur keq që shumë vërejtje dhe sygjerime të palëve nuk janë marrë parasysh fare nga Departamenti për Planifikim Hapësinor në MMPHI me rastin e diskutimeve publike të organizuara nga DPU në zonat urbane dhe rurale.

Për deri sa MMPHI dhe Ministrija e Ekonomisë kërkojnë nga komunat që në dokumente të Planifikimit në nivel lokal të përshtatet Strategjia e Energjisë 2022-2031 e cila është përkrahur edhe nga USAIDI dhe është publikuar edhe në Geoportal @rks-gov.net, e cila përfshinë edhe toka bujqësore madje Komunën e Mitrovicës e përfshin me një territor bukur të madh prej **80km²** që është në kundërshtim edhe me Qëllimet dhe Objektivat e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028. MMPHI kërkon nga komuna me harmonizue edhe ne Hartë Zonale Komunale, që eshte në kundërshtim edhe me Ligjin për Planifikim Hapësinor por edhe me U.A. për Norma Teknike për Planifikim Hapësinor.

Për deri sa Departamenti për Planifikim Hapësinor kërkon që në Hartën Zonale te Komunës së Mitrovicës së Jugut të inkorporohet Strategjia për energji të ripërtitshme që përfshin 25% të territorit të Komunës së Mitrovicës, në anën tjetër kjo Ministri respektivisht Departamenti për Planifikim Hapësinor vërejtjet dhe sygjerimet e qytetarëve gjatë diskutimit të Dokumentit të HZK-së në zonat urbane dhe rurale për ndryshime minimale e që janë plotësisht të arsyeshme thotë nuk bënë me i aprovue se ka shkelje Ligjore. Diskrepanca prej 6 viteve prej kur është miratuar PZHK 2020-2028 ka qenë një sfidë për Komunen e Mitrovicës pasi gjërat kanë evoluar edhe në teren.

Prandaj trajtimi i kërkesave të Ministrisë së linjes dhe i kërkesave të qytetarëve në mënyra të ndryshme është shkelje ligjore, për deri sa ato të MMPHI dhe Ministris se Ekonomisë duhet gjithsesi me i inkorporue e që nuk janë në harmoni me Ligjin 04/L-174 dhe U.A. që dalin prej tij, kurse ato te qytetarëve duhet me qenë 100 % në harmoni me PZHK-në edhe pse ky plan ka filluar të hartohet në vitin 2018 që i bie 6 vite diskrepancë. Sipas Ligjit 04/L-174 në PZHK percaktohen strategjitë, nuk percaktohen strategjit ne HZK-së, ashtu siq po e kërkon Departamenti per Planifikim Hapësinor.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0005239-3/24 dt. 31.01.2024
Mitrovicë

02-060/01-0005239-3/24
31.01.2024

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 nënparagrafi d, dhe 17, paragrafi 1 nënparagrafi b, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; nenin 5, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.2, nenin 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, nenin 20 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenin 7, të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së, Nr. 05/2014, Për Përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, nenin 13, paragrafi 1, neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe nenin të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut; si dhe pas pranimit të Vendimit për dhënie të Pëlqimit nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për hapje të Shqyrtimit Publik të Projektit "Harta Zonale" e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2023-2031; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 31.01.2024, pasi shqyrtoi Propozim-vendimin Nr. 02-350/01-0093729/23 dt. 29.12.2023 për shqyrtim publik të Projektit "Harta Zonale Komunale" e Mitrovicës së Jugut 2023-2031, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr.02-060/01-0002957-4/24 dt. 23.01.2024); sjell këtë:

VENDIM

Për shqyrtim publik të Projektit "Harta Zonale Komunale" e Mitrovicës së Jugut 2023-2031

1. Me këtë vendim shpallet në shqyrtim Publik i projektit "Harta Zonale Komunale" e Mitrovicës së Jugut 2023-2031, shqyrtim i cili organizohet 8 (tetë) ditë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Pas mbajtjes së shqyrtimit publik projekti vendoset për ekspozim në hapësira të caktuara me qëllim që të jetë i qasshëm drejtpërdrejtë për publikun dhe zgjatë 30 (tridhjetë) ditë, sipas procedurave të përcaktuara me Ligj.
3. Shpallja e shqyrtimit publik të projektit "Harta Zonale Komunale" e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2023-2031, bëhet 8 (tetë) ditë para hapjes së tij, përmes mjeteve të informimit publik, në faqen zyrtare të Komunës, si dhe në mediat televizive, publike dhe lokale.
4. Në shqyrtimin publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e projektit "Harta Zonale Komunale" e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2023-2031.
5. Projekti "Harta Zonale Komunale" e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2023-2031, do të jetë i qasshëm për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.
6. Projekti "Harta Zonale Komunale" e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2023-2031, i nënshtrohet vërejtjeve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

7. Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet të cilat paraqiten nga publiku gjatë diskutimit, regjistrohen në formë të shkruar në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar dhe përfshihen në raportin e shqyrtimit publik.
8. Pas përfundimit të projektit "Harta Zonale Komunale" e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2023-2031, Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm si autoritet përgjegjës për Planifikim Hapësinor, do të ndërmerr veprimet e parapara ligjore për finalizimin e këtij dokumenti në mënyrë që ai t'i propozohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.
9. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesja e Kuvendit



Vesa BROJA



Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm



Shënimet Drejtoria Drejtori	AL	Nr. i dëb. Ish. i dëb. Përsh. Nr.	855-2/24
Nr. i dëb. Ish. i dëb. Përsh. Nr.	-02	Datë: Drejtori	11.02.24
PRISHTINE / A			No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Për:	Bedri Hamza, Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut Vesa Broja, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Nr. VL-42/24 Datë: 13.02.2024
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.02-060/01-0005239-3/24 për shqyrtimin publik të Projektit "Harta Zonale Komunale" e Mitrovicës së Jugut 2023 - 2031, miratuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Jugut, datë 31.01.2024

I nderuar kryetar Hamza,
E nderuar kryesuese Broja,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullore (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, më datë 12.02.2024, ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr.02-060/01-0005239-3/24 për shqyrtimin publik të Projektit "Harta Zonale Komunale" e Mitrovicës së Jugut 2023 - 2031, miratuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Jugut, datë 31.01.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave:

KONFIRMON

Vendimin Nr.02-060/01-0005239-3/24 për shqyrtimin publik të Projektit “Harta Zonale Komunale” e Mitrovicës së Jugut 2023 – 2031, miratuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Jugut, datë 31.01.2024.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit Nr.02-060/01-0005239-3/24 për shqyrtimin publik të Projektit “Harta Zonale Komunale” e Mitrovicës së Jugut 2023 – 2031, konstatoi se:

Vendimi i lartcekur është në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor. Gjithashtu, Komuna e Mitrovicës Jugore ka përfituar pëlqim paraprak nga MMPHI për hapjen e shqyrtimit publik.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	26.02.2024
REFERENCË:	01-030/03 - 0014114/24
PËR/ZA/TO:	Znj. Blerina Kastrati - Udhëheqëse e Njesisë së Komunikimit me Publikun / Zyra e Informimit
NGA/OD/FROM:	Drejtorja për Planifikim dhe Urbanizëm z. Edison Tërnavë, Ark – Drejtor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM Për HAPJE TË SHQYRTIMIT PUBLIK

Bazuar në nenin 4, neni 5, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.2, neni 11 paragrafi 1.5 nënparagrafi 1.2.2, neni 11, paragrafi 1.5 dhe në nenin 20 të Ligjit Nr.04/L-174, për Planifikimin Hapësinor, nenin 4, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2, neni 5,6,7 dhe 8, Udhëzimit Administrativ Nr.24/2015, të MMPH-së Mbi elementet dhe kërkesat themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së, Nr. 05/2014, Për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinorë, si dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0005239-3/24, datë 31.01.2024, për Shqyrtim Publik të Projektit “Harta Zonale Komunale” e Mitrovicës së Jugut 2023-2031, Drejtorja për Planifikim dhe Urbanizëm, shpallë:

**NJOFTIM
PËR
HAPJE TË SHQYRTIMIT PUBLIK TË DRAFT DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT
HAPËSINOR
“HARTA ZONALE E KOMUNËS” Mitrovica e Jugut 2023-2031**

Komuna e Mitrovicës së Jugut, fton qytetarët, sektorin publik dhe privat, Ekspertet e fushave të ndryshme, grupet e interesit dhe të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë në procesin e Shqyrtimit Publik të Projekt - Dokumentit “HARTA ZONALE E KOMUNËS” Mitrovica e Jugut 2023-2031 i cili do të mbahet ditën e Merkurë, me datë 06.03.2024, në filluar nga ora 10:00, në hapësirat e Muzeut (ish Objekti i Armatës).

Kohëzgjatja e Shqyrtimit Publik është 30 (tridhjetë) ditë (kalendarike) nga data 07.03.2024 deri me datën 07.04.2024.

Draft-Dokumenti do të jetë në dispozicion të publikut dhe për të gjithë të interesuarit, për shqyrtim sugjerime dhe komente, çdo ditë pune prej ores 10.00h, deri në ora 16.00h, në hapësirat e Komunës dhe në ueb faqen zyrtare të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Me këtë dokument, të gjithë të interesuarit kanë mundësi të njoftohen me shfrytëzimet dhe kushtet e zhvillimit për secilën zonë, sipas rekomandimeve të Planit Zhvillimor Komunal të definuar me Hartën e Shfrytëzimit të planifikuar të tokës dhe Planet Zhvillimore Sektoriale.

Komentet, suxherimet dhe vërejtjet lidhur me dokumentin mund ti adresoni përmes postes elektronike në adresën: Nexhmi.Hasani@rks-gov.net, apo përmes dorëzimit në mënyrë fizike në

Zyrën Qendra për Shërbime për qytetarë, apo përmes shënimit në librin e vërejtjeve, brenda afatit kohorë të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik (nga data 07.03.2024 deri me datën 05.04.2024).

Çdo paraqitje lidhur me e vërejtje, apo komente, pas kësaj date nuk do të shqyrtohet.

Andaj, ftojme të gjithë të interesuarit, që të marin pjesë gjatë kohës sa do të qëndroj i hapur ky Shqyrtim Publik në mënyrë që të paraqitni vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja, para se të bëhet miratimi i Projekt-Dokumentit në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor dhe në fund miratimit nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Me respekt.

Drejtori i DPU-së

Edison Tërnavar.ark



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



PROCESVERBAL

Nga Hapja e Shqyrtimit Publik të Projekt-Dokumentit Harta Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032

I përpiluar me datën: 06.03.2024

Me Fillim në ora 10:00h

Vendi: Salla e Muzeut në Objektin e ish Armates.

Për Prezencën e të pranishmëve: Lista e bashkangjitur

Fillimisht Shqyrtimin Publik e shpalli të hapur Drejtori i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm z. Edison Tërnavë, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falenderoj për prezencë dhe për kohën që ka ndarë për të ju përgjigjë pjesmarrjes në këtë shqyrtim publik, ku ndër të tjera theksoi se pas këtij shqyrtimi do të rrjedhin vendime dhe hapa të jashtëzakonshëm, ndryshues, zhvillimorë, dhe vizionarë për qytetin tonë.

Sot do ta prezantojmë dokumentin e Planifikimit Harta Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032, dokument ky i cili përfshinë shumë sektor dhe i cili përcakton më konkretisht llojin, destinimin dhe shfrytëzimin e planifikuar të hapësirave në tërë territorin e Komunës.

Harta Zonale përcakton masat e veprimit të impelentimit, të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private në gjithë territorin e Komunës për një periudhë së paku 8 vjeqare.

Harta Zonale e Komunës si dokument ndërlidhet me sistemin e planifikimit hapësinorë dhe përmbanë pjesën tekstuale dhe hartografike, si dokument i shumë pritur dhe i rëndësishëm për të cilin është punuar gjatë, dhe me angazhim e përkushtim të jashtëzakonshëm ndërmjet shumë akterëve, organeve gjegjëse. Kjo pritet të sjellë zhvillime të reja urbane, sociale, kulturore dhe ekonomike në qytetin e Mitrovicës, duke ndërtuar kështu hap pas hapi por sigurtë një imazh të qytetit në të cilin duan të gjithë të jetojnë.

Në vazhdim para të pranishmëve dua të theksojë se ju si banorë të qytetit tuaj, si investitorë privat dhe ne si organe ekzekutive kemi pasur mundësinë e integritit të ideve dhe këndvështrimeve tuaja në këtë dokument jetik për secilin nga ju. Dhe tani sot ky dokument do të filloj jetsimin e tij drejtë hapjes së horizonteve të reja për ndryshime, integritime dhe zhvillime të cilat ne duam ti kem.

Për të prezentuar dokumentin fjalën ia kaloj Kompanisë Konsulente për hartimin e dokumentit të HZK-së INSI nga Prishtina.

Pasi e mori fjalën përfaqësuesi i kompanisë ndër të tjera theksoi se Harta Zonale e Komunës përmban pjesën tekstuale dhe hartografike, të cilat prezantohen në mënyrë digjitale dhe në format të shtypur për miratim dhe nënshkrim formal.

Pjesa tekstuale e Hartës Zonale të Komunës përmban kushtet zhvillimore dhe masat e mbrojtjes për të gjitha zonat të tërë hapësirës së Komunës, përfshirë zhvillimin e infrastrukturës teknike, publike dhe sociale, të gjitha në format A4, me pjesët vijuese:

1. Hyrja
2. Arsyetimi
3. Kushtet e përgjithshme për zhvillim për të gjitha Zonat
4. Lista e Zonave dhe Lista e Zonave Mbishtresore
5. Zonat e destinuar dhe Kushtet zhvillimore përfshirë Kushtet ndërtimore
6. Zonat Mbishtresore dhe Kushtet Zhvillimore
7. Infrastruktura Teknike
8. Infrastruktura Rrugore
9. Infrastruktura Publike dhe Sociale
10. Arsyetimi për nevojën e hartimit të Planeve Rregulluese të hollësishme të planifikuara
11. Plani i veprimit për zbatim
12. Administrimi, zbatimi dhe monitorimi i zbatimit
13. Ndryshim Plotësimi dhe përjashtimet.

Plani i Veprimit për Zbatim

Plani i veprimit për zbatim paraqet aktivitetet e parapara në Planin e veprimit nga Plani Zhvillimor Komunal përmes zhvillimit të projekteve konkrete të infrastrukturës teknike, publike dhe sociale, për qdo vit pasues duke përcaktuar si vijon:

1. Venddodhja e dedikuar, përfshirë edhe shpronsimet eventuale
2. Koston e përafërt të zbatimit
3. Burimet e parapara të financimit
4. Periudhen e zbatimit dhe
5. Institucionin për zbatim.

Komuna mund të shtojë aktivitete shtesë nga ato që kërkohen në Planin e Veprimit dhe në Planin Zhvillimor Komunal.

- Pjesëmarrja publike gjatë hartimit të dokumentit të Planifikimit Hapësinor, e me rastin e Hartës Zonale të Mitrovicës së Jugut.
- Digjitalizimi i të dhënave të Planifikimit Hapësinor, si bazë për hartimin, monitormin dhe zbatimit të projektit të HZK-së së Mitrovicës së Jugut.
- Projekt HZK e Mitrovicës së Jugut është hartuar duke u bazuar në Normat teknike të Planifikimit Hapësinor si bazë e hartimit dhe zbatimit të HZK-së në tërë territorin e Komunës.
- Gjithashtu projekt HZK i Mitrovicës së Jugut është bazuar edhe në Direktivat Evropiane: INSPIRE, përdorimi i tokës HILUCS(Hierarchical Land Use Classification) SHKSHT (sistemit hierarkik i klasifikimit të shfrytëzimit të tokës), si dhe rregullat mbështetëse HSRLC “Hierarcily of Supplementary Regulation Code List” KHRRP (Kodi hierarkik i rregullimit plotësues)

- Modeli i raportimit vjetor dhe monitorimit të zbatimit të HZK-së në Komunën e Mitrovicës së Jugut para organit vendimmarrës (Kuvendit të Komunës) dhe dorëzimi i raporeteve të miratuara në MMPH, që janë trajtuar.

Kjo ishte prezantimi i dokumentit në pika të shkurta nga INSI, kurse fjalën i'a kaloi Drejtorit të DPU-së për të vazhduar me pikat tjera për të cilat është shpallur njoftimi për shqyrtim publik i cili ndër të tjera i'u drejtua të pranishmëve se mund të na shtojnë pyetje lidhur me Draft-Dokumentin dhe mund të bëjnë vërejtje lidhur me të cilat do të mundohemi që të japim përgjigje.

Pas këtij fjalimi disa të pranishëm të interesuar filluan me parashtrimin e pyetjeve rreth Draft-Dokumentit.

Lidhur me këtë zyrtari përgjegjës në cilësi të Koordinatorit për hartimin e dokumentit të planifikimit, z. Nexhmi Hasani, pasi i përshendetit të pranishmit, theksoi se para se gjithash organizimi i shqyrtimit publik, është obligim që e përcakton Ligji i aplikueshëm për Planifikim Hapësinor Udhëzimet Administrative, dhe po ashtu vendimi i Kuvendit të Komunës, para se të finalizohet ky Dokumenti i Planifikimit. Pastaj qëllimi i mbajtjes së shqyrtimit Publik të Dokumentit është që qytetaret, grupet e interesit , shoqëria civile si dhe të gjithë të interesuarit të njoftohen me përmbajtjen e dokumentit dhe të jenë të kyçur në parashtrimin e pyetjeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve, të cilat mund të inkorporohen në dokument, dhe se për të arritur deri te hartimi i Hartes Zonale, si dokument i rendësisë së veçantë, është punuar një kohë të gjatë duke u angazhuar në vazhdimësi ne si autoritet përgjegjës e po ashtu edhe Kompania e përzgjedhur për Hartimin e Dokumentit të Planifikimit., e që Komuna është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit për 8 (tetë) vitet e ardhshme.

Në vazhdim disa të pranishëm filluan me pyetje, ku i drejtonin të përgjegjësit e Urbanizmit, kurse disa të tjerë i drejtoheshin përfaqësuesit të Kompanisë Hartuese INSI. Pas disa përpjekjeve për të dhënë përgjigje në pyetjet e tyre, Koordinatori i njoftoi të pranishmit se dokumenti duke filluar nga dita e nesërme do të jetë i publikuar në afat kohorë për 30 (tridhjetë) ditë, në ueb faqen zyrtare të Komunës si dhe në hapësirat e objektit të Komunës me qëllim që të gjithë të interesuarit të paraqesin vërjetje, sugjerime, komente në formë digjitale apo edhe duke paraqitur kërkesat e tyre në formë fizike të cilat dorëzohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, për Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm, apo në email adresën (nexhmi.hasani@rks-gov.net) çdo ditë pune dhe të gjitha vërejtjet komentet apo sugjerimet do të shqyrtohen dhe do të marrin përgjigje e po ashtu të njëjtat do të inkorporohen në dokument para miratimit nga MMPH dhe Kuvendi i Komunës.

Përfundoi në ora 13.00h.

Procesmbajtësi

Xhevdet Aruqaj

Zyrtarë Ligjorë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm- DPU

SHQYRTIM PUBLIK

PROJEKT-DOKUMENTI HARTA ZONALE E KOMUNËS SË
MITROVICËS SË JUGUT 2023-2031

Vendi: Hapësira e Muzeut, në Objektivin e ish Armates

Data: 06.03.2024

Ora :10:00h

LISTA E PJESMARRËSVE

	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi Tel:/emaili:	Nënshkrimi
1	Kushtetim Hoti	049 228 232	
2	Sabit Pllani	049 661-474	
3	GANI GRXHAZIJA	049-314151	
4	Enes Qulluci	049-242241	
5	Mehdi Isakaj	049 29 19 59	
6	Faik Hasani	049/174-865	
7	Nzemi Behr	048 405 116	
8	BILIM JASHARI	044 788 351	
9	Xhafa Jaku	0591540863	

10	Bejtullah Bejta	044293093	
11	SHAIK RABRIM		044 74-093
12	ANDA VOKSHI ^{PGA} USAID	048 396 314	A. Vokshu
13	LEOTRIM ^{USAID/PGA} GERMIAJ	049 8533 85	
14	ALBERT HACILAJ	049611110	
15	KUSHTRIM JANUZI	049 869 246	
16	BESA VESELI		
17	Medina Staluku	010424720	
18	FIRNIK CITAKU	049 171020	F. Citaku
19	Besa Hasani	049/245755	
20	Mjherina Rexha	049 451 880	
21	SHAMSUDIN BAJRAMI	049/467 625	
22	IZET MAXHERA	044/146 633	
23	JOSUF JASHARI	044-1212-929	
24	NIJAZI JASHARI	049 665 556	
25	Flojbe Prokazi	044 124 244	
26	Shpend Hoti	049 849 788	
27	SKREMPERCI	049 146 176	
28	ARBEN ZEQRIRI	049 330 370	
29	FLORENT HAXHIMHMETI	049 133 033	
30	Gjylferride Ademi	049 734 634	
31	ISMAIL SYLA	044/165 974	
32	FEJZULAH HAXHANI	044/164 361	

33	Remzi Muja	049734740 Mihonice	Remzi
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			
49			
50			
51			
52			
53			
54			
55			
56			



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm- DPU

SHQYRTIM PUBLIK

PROJEKT-DOKUMENTI HARTA ZONALE E KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT 2023-2031
























Vendi: Hapësira e Muzeut, në Objektin e ish Armates

Data: 06.03.2024

Ora :10:00h

LISTA E PJESMARRËSVE

	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi Tel:/emaili:	Nënshkrimi
1	FLAKRIM AJETI	049-228-344	
2	XHEVAT SMASHI	SAMI GASHI 044 235 240	
3	VLORA ZYMBËRI JUSUPI	vlorazymbერი@kru- mitrovica.com	
4	FATBARDHA AUDIU	044 630 719	
5	SHYHRETE PEÇI	049683588	
6	SEBASTIANE DURAKU	049773774	
7	Dea Kesteku	FERAT DRAGAJ 045 590 780	
8	Salih Meha	shipol 049 114 609	
9	Xhevat Kociku	04485 90 98	

10	BASHKIM MUHARREM	MITROVIC 049 12624 26	
11	MUSTAFA RANADAN	5110 0022 049 606 572	
12	Xhevdet IMERI	049 345 980	
13	ADEM ZHITOPOTOKU	044 7272 77	
14	Ushim Preraj	044 214-030	
15	Armi Kestranj	049-500-427	
16	MUHARREM TAHIRI	045-892-430	
17	MEHMET BAHIRI	049 386 619	
18	FATMIR BULIQI	049 100 893	
19	ALBAN BULIQI	049 442 908	
20	FISNIK ABRASHI	045 965 585	
21	BESIM BEKA	049 158924	
22	Hashim Bekteshi	049 726 387	
23	Blerim Mehulli	044/273-388	
24	BESIM SHATA	044/164-186	
25	SHENAJ HAPASHICA	044/899-033	
26	ERDAN JASHARI	049/616-142	
27	Ilir Imeri	045/237 237	
28	Egzon Isllani	049/360006	
29	ARTAN BENISHA	045-609072	
30	DRIZ BEQIRI	049-147-677	
31	VEJDI REXHI	049/749-685	
32	Xhevdet Arucay	049/734/706	

NEXITHU HASANI	044-147-801	N. Hasani
RIDUALI ALUSHI	045-620-704	_____
BERAT ALUSHI	049-363-555	B. Huri
MUHAMED ALUSHI	046-955-555	M. Huri
SEDDAT ALUSHI	049 812 878	S. Huri
ISMET ALUSHI	049-615 484	I. Huri
LINDITA OSMANI	045 308 261	L. Osmani
REMIJE HAMITI	044 116 986	R. H.
FAIK HAMITI	044 136 580	_____
AFRIM MAXHERA	049 308 795	A. Maxhera
Haxhi Salihu	049 926 137	H. Salihu
NEXHAT SHABANI	049 893-560	N. Shabani
Muesat Veret	049 445-704	M. Veret
ASTRIT HAZOARI	049 320 256	A. Hazoari
ARIBEN SAKATI	049 444-262	A. Sakati
MILAIM JASHARI	049,953,704	M. Jashari
BEDRI ASLANI	044 330 880	B. Aslani
FERAT MAMUETI	045 506 443	F. Mamueti
BEKXHET METI	049 345 980	B. Meti
MIRSAJ BEKTESHI	049 754 397	M. Bekteshi
SHEFQET BEKTESHI	049 754 397	S. Bekteshi
ASTRIT SHAQIRI	044 365 372	A. Shaqiri
FRIZ VARRIU	049 686 35	F. Varriu
ARSIM SHABIRI	049-225070	A. Shabiri

	Istom Hojdarni	049-292-911	<i>[Signature]</i>
	BESFORI XHEMAJLI	049 660-661	<i>[Signature]</i>

Mitrovicë e Jugut
Datë: 06.03.2024

Foto nga takimi i Shqyrtimit Publik të HZK-së



Foto nga takimi i Shqyrtimit Publik të HZK-së



Foto nga takimi i Shqyrtimit Publik të HZK-së



Përmbledhje e rekomandimeve dhe vërejtjeve nga aktiviteti i Shqyrtimit Publik të HZK-së, në Komunën e Mitrovicës së Jugut. (Rekomandimet dhe Vrejtjet e dorëzuara në formën fizike në DPU)

Nr.	Burimi i Rekomandimit	Numri i Lëndes	Komenti/Vërejtja/Sugjerimi	Pranohet/Refuzohet	Arsytimi i pranimit apo refuzimit të komentit
1	Visar Shaqiri	08-350/04-0018244/24, dt. 11.03.2024	Parcela me nr. P-71208114-01022-0 (ZK.Suhodoll) me Draft HZK-në është kategorizuar si ZI-1 (Zonë Industriale), të kalojë në Zonë banimi me shumë njësi, për arsye se të gjitha parcelat për rrethë saj janë kategorizuar si ZSHP-5.	Miratohet	Parcela e cekur në Kërkesë është vazhdimësi e zonës me destinim ZSHP-5.
2	Shefqet Kurti	08-350/02-0019388/24, dt. 18.03.2024	Parcela me nr. P-71208067-01018-10 (ZK-Kovaqicë) sipas Fletës poseduese është Tokë e Klasës së 7-të, aty ka qenë para lufte Fshati, andaj kerkojm qe me HZK -në, destinim I tokes te kaloj nga Zone Pyjore ne Tokë ndertimore.	Miratohet	Ajo zonë edhe me PZHK 2020-2028 te Qëllimet dhe Objektivat është përcaktuar si potencial për zhvillim të turizmit, nuk është zonë e mbrojtur, toka është e kategoris së 7-të, tokë jo pjellore.(para lufte ka pasë shtëpi në atë pjesë)
3	Naim Imeri	08-350/02-0018570/24, dt. 12.03.2024	Kërkoj që Parcelat me nr. 242-0, 241-0, 243-1, 244-2, 239-5, 243-4 në Zonën Kadastrale Lushtë të bëni ndryshmin e destinimit nga Banim Individual ne Zonë Komerçiale.	Miratohet	Këto parcela shtrihen në rr. Regjionale Mitrovicë-Skenderaj, dhe afër tyre ka veprimtari komerciale
4	Gani Gërgjaliu	08-350/02-0019967/24, dt. 19.03.2024	Kërkoj nga DPU që Parcela me nr. 03827-1 Zk.Mitrovicë me sipërfaqe 60 ari me draft HZK është ZB4 , unë kërkoj qe kjo parcelë të jet ZB5 sepse është vazhdimësi e parcelës e cila është ZB5 , e jo te ndërpritet Zb5 bash te parcela ime. Kerkoj qe te me trajtoni ne menyre te barabart sikurse parcelat fqinje, jo te me diskriminoni. Unë Gani Gerxhaliu ja fala Komunës time 5 ari pa kurfar kompenzimi per hapjen e dy rrugëve publike pa kërkuar kurfar kompenzimi , dhe në fund fqinjët e mi te përfitojn ne kurriz timin pa falur as nje ari tokë me duket shumë diskriminuese.	Miratohet	Parcela me nr. 03827-1 ndodhet në vazhdimësi të zonës me destinim ZB-5, dhe afër kompleksit "Amina".
5	Jahë Osmani		Kërkojë nga DPU që Parcelat me nr. 2681-9, 2681-3 Zk. Mitrovicë, të kalojn nga ZB 4 në ZB5, ashtu siq jan parcelat fqinje.	Miratohet	Parcelat e cekur në Kërkesë janë vazhdimësi e zonës me destinim ZB-5, dhe afër kompleksit "Amina".
6	Mirsad Bekteshi	08-350/02-0018829/24 dt. 13.03.2024	Kërkoj nga DPU qe parcelën me nr. P-71208128-02310-0 (ZK.SHUPKOVC) me rastinë shqyrtimit publik ta ndryshoni destinimin nga ZB3 ne ZK1, pasi afër meje ekziston nje parcelë e tillë	Miratohet	Parela ndodhet në rr. Regjionale Mitrovicë- Podujevë dhe aty afër ka veprimtari komerciale si QTA.
7	Salih Bekteshi	08-350/02-0018827/24 dt. 13.03.2024	Kërkoj nga DPU qe parcelen me nr. P-71208128-02307-5(ZK.Shupkocv) me rastine shqyrtimit publik ta ndryshoni destinimin nga ZB3 ne ZK1, pasi afer meje ekziston nje parcel me destinim të tillë.	Miratohet	Parela ndodhet në rr. Regjionale Mitrovicë- Podujevë dhe aty afër ka veprimtari komerciale si QTA.

8	Shaip Kadriu	08-350/02-0020456/24 dt.21.03.2024	Kërkoje që parcela me nr. P-/1208128-00625-0 që destinimi nga Banim individual te destinohet për biznes dhe banim te larë.	Refuzohen	Parcela ndodhet në zonën sub-urbane te qytetit, ku dendësia e popullësis është e vogël.
9	Visar Shaqiri	08-350/02-0018741/24 dt. 13.03.2024	Kërkojë nga DPU dhe Kompania hartuese që parcela me nr. P-71208072-01522-1,(ZK.Mitrovicë) te kaloj nga ZM2 në ZKT, pasi e gjithë zona eshte ZKT1, dhe gabimishtë është futur ne ZM pasi aktiviteti i saj ka qenë dhe është ZKT1 edhe tani.	Miratohet	Parcela me nr. P-71208072-01522-1 është pronë private dhe është vazhdimësi e kompleksit ZKT1
